VENDIM
Nr. 538, datë 25.7.2019

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 190, ZONA KADASTRALE 1565, BASHKIA TEPELENË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 190, zona kadastrale 1565, Bashkia Tepelenë, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Gjirokastër, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 190, zona kadastrale 1565, Bashkia Tepelenë.
3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Gjirokastër dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Nr. 920 Prot.
20.05.2019

NJËSHAR ME ORIGJINALIN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 470259

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit TEPELENE Zona Kadastrale Nr. 1565

Numri i Pasurisë 190 Volumi 2 Faqe 102

Adresa e Pasurisë DUKAJ - TEPELENE

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 2800 m^2 (DYMIJE E TETERINO)

Nga kjo : Sa Truall = Nga kjo : Sa Ndërtesa =

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes = %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
FELIKS	BEDO	HYSA	I	TIRANE

- është pronar i PASURISE 190
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart = =
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi = =
- kufizimet e pasurisë janë : V 58/7 , L 58/7 , J 58/7, 188 , P 58/7

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 21.04.2014 Nr. 636

Data e leshimit të çertifikatës
09.05.2014

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
Abdul Momaj

HARTE TREGUESE E REGJISTRIMIT (FRAGMENT)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
TEPELENE

PUNOI: ALFRED CACA

REGJISTRUES

Pëllumb MILORI

A.IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE 1565 NR I PASURISË 130 Vol. 2 Fq 102

INDEKSI I HARTES K-34-136-(15-A) SHKALLA 1:2000

ADRESA E PASURISË: RRETHI TEPELENE BASHKIA LUNGO

Rr/Lagje ____ P/G ____ SH ____ K ____ Ap ____

B. KUFIZIME

V. 58/7

L. 58/7

J. 58/7 ; 188

P. 58/7

D Data: 27/12/2016 Ora: ____

C. PRONARI/E

FELIKS HOXHA